



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVA



REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	03.10.2025
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkyetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – SHTATOR 2025

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2025, ju dorëzon:

RAPORTIN MUJOR
TË PUNËS PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 01.09.2025-30.09.2025

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM- në sektorin e Urbanizmit ka zhvilluar aktivitetet themelore si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuar dhe kërkesave të bartura. Gjatë muajit shtator 2025-janë pranuar gjithsejtë 73-kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura kanë qenë 21 lëndë, që në total rezulton të jenë 94 lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 63 kërkesa, 40 të miratuara, 22 të refuzuara dhe 1 e ceduar. Për shqyrtim në muajin vijues barten 31 lëndë të natyrave të ndryshme.

Statusi i trajtimit të lëndëve të pranuar dhe atyre të bartura është prezantuar në pjesën tabelare.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer edhe aktivitete të tjera.

Në fushën e shqyrtimit të kërkesave është vazhduar me intensifikimin e angazhimeve për shqyrtimin e tyre brenda afateve ligjore.

Lidhur me lëndët e pakompletuara, DPUMM ka bërë lëshimin e 5 ftesave për kompletim të lëndës.

Pjesë e veçantë e shqyrtimit të kërkesave është edhe procedura e lëshimit të konkluzioneve për pagesën e taksave sipas kategorive të caktuara. Lidhur me këte janë lëshuar 17 konkluzione për pagesën e taksave.

Po, ashtu DPUMM ka përgatitur dhe adresuar te palët ftesa për plotësimin e dokumentacionit. Në kuadër të kësaj janë lëshuar 5 ftesa për kompletim të lëndëve. Njëkohësisht ka pranuar dhe shqyrtuar 5 kërkesa shtesë për plotësim dokumentacioni.

DPUMM ka trajtuar dy kërkesa për ekspertizë gjyqësore. Kërkesat janë proceduar me kohë.

DPUMM ka shqyrtuar një akt të MMPHI për aprovimin e ankesës së një pale dhe lidhur me këte ka iniciuar konfliktin administrativ.

DPUMM ka vazhduar pranimin e kërkesave për ndryshimin e Hartës Zonale të Komunës. Gjatë muajit shtator janë pranuar 2 kërkesa të tilla të cilat do të trajtohen në procesin e ndryshim plotësimit të HZK-së.

Aktivitete të tjera janë kryer edhe si:

Është në zbatim e sipër programi për regjistrimin e adresave zyrtare, proces që zbatohet nga AKK. Procesi mbikëqyret dhe mbështetet nga DPUMM.

Aktivitetet themelore për muajin vijues:

Vazhdimi i angazhimeve për shqyrtimin e lëndëve.

Vazhdimi i bashkëpunimit me Drejtoratet relevante në procesin implementues të projekteve komunale.

STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Tabela 1.

Nr.	Llojet e kërkesave	Të pranuar	Nga periudha e kaluar	Të miratura	Pushim procedure	Të refuzuar	Të bartura në sektor të tjerë	Në proces (pritje)
1.	Kushte ndërtimore	6	5	5		2	1 ¹	3
2.	Leje ndërtimi	16	2	5		4		9
3.	Plotës.ndr. i LN	1				1		
4.	Plotësim i k.ndërtimore	2		2				
5.	Leje ndërt.-ujësjellës	1		1				
6.	Leje rrënimi	2	1	1				2
7.	Tërheqje lande	3		2				1
8.	Akte nga MMPHI- rish.	1	1	1		1 ²		
9.	MKRS-njoftime	4		4				
10.	Informacione urbane	4	0	2				2
11.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	7	4	3		2		4
12.	Legalizimi/ Në listë të pritjes			2				
13.	Bashkim/ndarje e parcelave	4	4	3		5		
14.	Kërkesë për LMK	11	2	4		2		7
15.	Detyra për hartim të projekteve	1		1				
16.	Dokumente për një anëtarë komisioni	1						1
17.	Ndërrim destinimi	2				1		1
18.	Pëlqim për panele solare	1	1	1		1		
19.	Emërtim rruge	2	1			2		1
20.	Shtyrje afati për LN	1		1				
21.	Zhvendosje e rrjetit ele.	1				1		
22.	Dokumente për ekspert gjyqësor	2		2				
	Gjithsejtë:	73	21	40		22	1	31

¹ Një lëndë për kushte ndërtimore është bartur në kompetencë në MMPHI për shkak se lokacionigjendet në kuadër të zones së mbrojtur në Lipjan dhe sipas legjislacionit në fuqi kjo çështje kalohet në kompetencë në organin kompetent administrative.

² MMPHI ka miratuar ankesën e një pale për vendosjen e lodrave në pronën përgjatë hekurudhës dhe rrugës “Skënderbeu”. Lidhur me këtë kemi përgatitur lëndën për iniciimin e Konflikt administrative në Gjykatën kompetente.

Sipërfaqja tokësore për ndërtim, sipërfaqja e ndërtesave dhe destinimi

Tabela 2.

<i>Nr.</i>	<i>Kategoria e ndërtimit</i>	<i>Sipërf. Tokës – m2</i>	<i>Sip.ndëtesës- m2</i>	<i>Destinimi</i>	<i>Vendi</i>
1.	II	4650	9225.4 B 1981.4 A	NLB	Lipjan
2.	II	5071	2534	Afarsit	Konjuh
3.	I	2466	537	Afarist	Gadime e Epër
4.	I	1000	74.94	Shtëpi	Rubovc
	I	1295	250.09	Shtëpi	Grackë e Vjetër
Gjithsejtë		14482	14602.83		

Tokë e shfrytëzuar vetëm për banim = 2295 m2 me gjithsejtë ndërtim prej 325.03 m2. Kurse tokë e shfrytëzuar vetëm për afarizëm = 7537 m2 me gjithsejtë ndërtim për afarizëm prej 3067 m2 dhe tokë e shfrytëzuar për banim dhe afarizëm në qytet 4650 m2 në të cilën janë ndërtuar 9225.4 m2 për banim dhe 1981.4 m2 për afarizëm (NLB).

DISKUTIME PUBLIKE:

Gjatë muajit shtator 2025 nuk kemi pasur ndonjë diskutim publik.

SFIDAT:

- Mungesë e theksuar e stafit në punë për shkak të pushimeve mjekësore;